Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Ekonomisë dhe Financave - Ministarstvo Privrede i Finansija - Ministry of Economy and Finance

---

Administrata Tatimore e Kosoves - Poreska Administracija Kosova - Tax Administration of Kosovo

UDHËZIMIN ADMINISTRATIV NR. 09 / 2010
PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 03/L-161, PËR TATIMIN NË TË ARDHURAT PERSONALE

Ministria e Ekonomisë dhe Financave

Mbështetur në nenin 50 të ligjit nr 03/L-161, *"Për Tatimin në të Ardhurat Personale "*, Ministri i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave,

nxjerr:

UDHËZIM ADMINISTRATIV
PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR 03/L-161, PËR TATIMI NË TË ARDHURAT PERSONALE

Neni 1
Qëllimi dhe Fushëveprimi

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është vendosja e procedurave dhe kërkesave për zbatimin e dispozitave të Ligjit nr 03/L-161, *"Për Tatimi në të Ardhurat Personale"*, (në tekstin e mëtejmë i referuar si Ligji).

Neni 2
Përkufizimet

1. Paragrafi 1.5 i nenit 2 të Ligjit përcakton një "**Të punësuar**" si person fizik, i cili kryen punë kundrejt pagesës sipas urdhrit dhe nën kontrollin e një punëdhënësi. Personi fizik i cili nuk quhet i punësuar, por ndryshe, si "drejtor","zyrtarë", "parlamentar", "ministër", "nëpunës" etj, do të konsiderohet se është i punësuar nëse përmbushen së paku dy nga katër kushtet në vijim:

1.1 kur i punësuari nuk është në rrezik për marrjen e pagesës,
1.2 kur i punësuari nuk ka nevojë të investojë në instrumentet e punës, mjetet dhe pajisjet,
1.3 kur i punësuari nuk e përcakton vendin dhe kohën e punës, dhe
1.4 si rregull i përgjithshëm një i punësuar nuk punon për më shumë se një punëdhënës.

2. Paragrafi 1.8 i nenit 2 të Ligji definon "**Punëdhënësin Kryesor**" si *"punëdhënësi i caktuar nga i punësuari si i tillë në një kohë dhe në mënyrën e përcaktuar me akt nën-ligjor të nxjerrë nga Ministri".*

2.1 Çdo i punësuar, nëse punon për një apo më tepër punëdhënës, do të caktojë një punëdhënës kryesor. Të punësuarit, të cilët më parë kanë caktuar punëdhënësin e tyre kryesor dhe që nuk duan të ndryshojnë punëdhënësin e tyre kryesor, nuk janë të nevojshme për të ndërmarrë ndonjë veprim shtesë të caktimit.
2.2 Të punësuarit që fillojnë punën do të caktojnë punëdhënësin kryesor brenda 15 ditëve nga data e fillimit të punësimit duke plotësuar dhe dorëzuar formularin mbi caktimin e punëdhënësit kryesor (në formatin e përcaktuar nga Administrata Tatimore e Kosovës) në Administratën Tatimore të Kosovës. I punësuari i cili ndryshon punëdhënësin kryesor duhet të caktojë punëdhënësin e ri kryesor brenda 15 ditësh nga dita e ndryshimit, duke plotësuar dhe dorëzuar formularin e ri mbi caktimin e punëdhënësit kryesor në Administratën Tatimore të Kosovës.

3. Paragrafi 1.21 i nenit 2 të Ligjit definon "**Rezidentin**" si një person fizik i cili ka një vendqëndrim kryesor në Kosovë, ose fizikisht është i pranishëm në Kosovë për 183 ditë apo më gjatë në cilëndo periudhë kohore prej dymbëdhjetë muaj; apo një entitet, ndërmarrje personale e biznesit, ortakëri, apo shoqatë e personave që është themeluar në Kosovë ose ka vendin e vet të menaxhimit efektiv në Kosovë ".
3.1 Në lidhje me individët:
3.1.1 Kërkesa prej 183 ditësh nënkupton numrin total të ditëve të prezencës fizike në Kosovë, me ose pa ndërprerje. Në qoftë se një pjesë e ditës është kaluar në Kosovë duhet të llogaritet si një ditë e plotë e kaluar në Kosovë.
3.1.2 Termi "**Rezidenca Kryesore** *"e* një individi nënkupton vendin ku jeton familja e individit , ku janë të lidhura interesat kryesore të jetës së individit dhe të ngjashme. Gjithashtu në përcaktimin e vendbanimit (rezidencës) kryesor duhet të merret parasysh gjatësia e kaluar e kohës dhe natyra e kohës së kaluar .

3.2 Në lidhje me entitetet:
3.2.1 Kërkesa për të qenë "**I vendosur**" *në* Kosovë nënkupton entitetin që pavarësisht se a është organizatë biznesi, organizatë jo-fitimprurëse ose një organ qeveritar etj, është themeluar sipas ligjit të Kosovës dhe është regjistruar nga autoritetet përkatëse kompetente në Kosovë.
3.2.2 Termi "**Vendi i Menaxhimit Efektiv** *"* nënkupton vendin ku mblidhet shumica e drejtorëve ekzekutiv dhe udhëheqin punën në

operacionet e përditshme. Kjo nuk e nënkupton domosdoshmërish drejtorinë e entitetit

Neni 3
Të Ardhurat Bruto

1. Paragrafi 1 i nenit 7 të Ligjit të ardhurat bruto nënkupton të gjitha të ardhurat që janë pranuar aktualisht dhe në mënyrë konstruktive nga një varg i burimeve. Në lidhje me burimet e mëposhtme, shprehja *"të pranuara me të vërtetë dhe në mënyrë konstruktive"* ka kuptimin si në vijim:

1.1 *Pagat.* Zakonisht pagat paguhen një herë, dy herë ose edhe më shumë herë në një muaj edhe pse shërbimet e punësimit kryhen në baza ditore. Të ardhurat nga pagat do të përfshihen në të ardhurat bruto të periudhës tatimore në të cilën paguhet paga nga punëdhënësi dhe pranohen nga i punësuari dhe shpenzimi i pagës do të kërkohet nga punëdhënësi si zbritje në periudhën e njëjtë tatimore. I njëjti parim vlen edhe për detyrimin për ndaljen e tatimit në burim në paga - ky detyrim lind vetëm kur pagat në të vërtetë janë paguar ,e jo kur të jetë përllogaritur detyrimi i pagave në librat e tatimpaguesit. Çdo pjesë përbërëse e "pagave" që nuk është paguar në para të gatshme, duhet gjithashtu të përfshihet në të ardhurat bruto të periudhës tatimore në të cilën është pranuar kjo komponent.

Shembull:

Punëdhënësi punëson një person gjatë muajve prill deri në qershor të vitit 2010. Punëdhënësi i paguan të punësuarit pagën e prillit në maj të vitit 2010 dhe tatimin në burim në këto paga ai e paguan në qershor të vitit 2010 (para afatit të 15 qershorit). Për shkak të vështirësive të qarkullimit të – parave të gatshme ai vonohet në pagesën e pagave të mbetura të të punësuarit. Pagat e Majit nuk paguhen deri në tetor të vitit 2010 dhe tatimi i mbajtur në burim në këto pagat paguhet në nëntor të vitit 2010 (para 15 nëntorit). Pagat e qershorit nuk paguhen deri në janar 2011, por tatimi i mbajtur në burim në këto pagat nuk është paguar deri më 15 mars 2011. Pasojat tatimore janë:

1. i punësuari përfshin pagat e prillit dhe majit në të ardhurat e tyre bruto të vitit 2010, por pagat e qershorit përfshihen në të ardhurat bruto të tyre të vitit 2011, kur këto paga në të vërtetë janë pranuar;
2. punëdhënësi merr zbritje tatimore për pagat e prillit dhe majit dhe për pagesën e tatimit të mbajtur në burim për to në vitin 2010, por zbritja për pagat e qershorit dhe tatimit i tyre i mbajtur në burim nuk lejohet deri në vitin tatimor 2011 , vit ky në të cilin janë paguar pagat dhe tatimi;
3. punëdhënësi është i detyruar që të plotësojë formularët mujor për tatimin e mbajtur në burim vetëm për muajt kur është paguar i punësuari(maj 2010, tetor 2010 dhe janar 2011);
4. interesi apo ndëshkimet nuk zbatohen në lidhje me tatimin e mbajtur në burim në pagat e prillit dhe të majit (edhe pse pagat e majit nuk janë paguar deri në tetor dhe tatimi nuk është paguar deri në nëntor, sepse detyrimi tatimor mbështetet në atë se kur në të vërtetë paguhen pagat);
5. interesi dhe ndëshkimet për deklarim / pagesë me vonesë do të aplikohen në lidhje me pagat e qershorit – meqë këto paga janë paguar në janar të vitit 2011, tatimi në burim për tu paguar në këto paga ka qenë deri më 15 shkurt

2011, mirëpo nuk është paguar deri më 15 mars 2011. Mirëpo interesi dhe ndëshkimet do të aplikohen vetëm për periudhën nga 15 shkurti deri më 15 mars 2011 (ato nuk kthehen prapa në qershor të vitit 2010 kur janë fituar pagat, në korrik 2010 kur i punësuari normalisht është dashur të paguhet ose në gusht 2010 kur tatimi i mbajtur në burim në këto paga normalisht është dashur të paguhet) .

1.2 *Qiratë*. Të ardhurat nga qiraja e pasurisë së paluajtshme ose të luajtshme në përgjithësi duhet të raportohen në periudhën tatimore në të cilën janë pranuar të ardhurat nga qiraja pavarësisht nga periudha të cilës i takon pagesa e qirasë. Megjithatë, në pajtueshmëri me paragrafin 2 të nenit 11 të Ligjit, tatimpaguesit që zhvillojnë biznes të dhënies me qira të pasurisë së luajtshme apo të paluajtshme duhet të llogarisin për të ardhurat e tyre nga qiraja duke u bazuar që këto të ardhura janë krijuar nga një aktivitet ekonomik.

Shembulli 1:

Tatimpaguesi A ka dy pronat për banim, në njërën prej të cilave ai jeton dhe tjetrën të cilën e jep me qira. Ai/ajo e ngarkon qiramarrësin me dy vite qira në avanc. Edhe pse qiraja përfshinë më shumë se një vit,Tatimpaguesi A është i detyruar që të përfshijë atë të tërën në të ardhurat bruto të tij/saj në periudhën tatimore për të cilën është pranuar qiraja. Në kuptim të zbritjes së shpenzimeve të qirasë nëse tatimpaguesi A zgjedh që mos të mbaj regjistrime sipas nenit 27 të ligjit, ai/ajo mund të zbret 10% të qirasë totale të pranuar, mirëpo sikur ajo/ai të kishte mbajtur regjistrime për qëllim të kërkimit të shpenzimeve të vërteta ata do të ishin në gjendje që të zbresin vetëm shpenzimet e qirasë që lidhen me çdo periudhë tatimore sikurse kanë lindur.

Shembulli 2:

Tatimpaguesi B ka një numër të madh të pasurive dhe e kalon kohën e tij /saj të punës në mirëmbajtjen e këtyre pasurive. Tatimpaguesi A pranon qira e cila i nënshtrohet tatimit, kur këto qira të jenë pranuar. Tatimpaguesi B zhvillon aktivitet ekonomik të dhënies me qira dhe është i detyruar të llogarisë për tatim në të ardhurat e tij/saj të qirasë në përputhje me nenin 32 të Ligjit - për shembull, ku tatimpaguesi merr me qira të ardhura vjetore prej më shumë se 50.000 €, ky tatimpagues është i detyruar që të llogarit për të ardhurat e tij nga qiraja na baza akruale.

Shënim: Në të dy shembujt 1 dhe 2 ndryshe nga trajtimi tatimor i pagave, koha se kur qiradhënësi i pranon të ardhurat nga qiraja dhe i përfshinë ato në të ardhurat e tij/saj bruto,nuk ka ndikim se kur personi që e paguan qiranë mundë të kërkojë zbritjen tatimore të shpenzimit për qiranë e paguar. Pra me qiranë e paguar si avanc mundë të ketë situata kur qiradhënësi duhet të përfshijë të ardhurat e qirasë në deklaratën tatimore në fillim të periudhës së qirasë,mirëpo qiramarrësi nuk mundë të kërkojë shpenzimet e qirasë deri në periudhat të cilave ju përkasin.

1.3 *Interesi*. Të ardhurat nga interesi do të raportohen në periudhën tatimore kur ky interes është paguar apo kredituar në llogarinë e pranuesit.

Shembull:

Një person investon fonde në një depozitë bankar të afatizuar për një periudhë gjashtë mujore. Interesi i shtohet bilancit të depozitit të afatizuar për çdo muaj. Në fund të periudhës prej gjashtë muajsh, personi vendos për të mbajtur fondet në depozitin e

afatizuar për gjashtë muaj të tjera. Interesi i kredituar në bilancin e llogarisë për çdo muaj do të përfshihen në të ardhurat bruto në muajin në të cilën është kredituar. Trajtimi tatimor mbetet i njëjtë pavarësisht se a është tërhequr interesi për çdo muaj ose jo, dhe pavarësisht nëse fondet nga depoziti I afatizuar janë tërhequr apo ri-investuar pas përfundimit të gjashtë muajve të parë apo nëse depoziti I afatizuar thjesht është "vazhduar". Edhe pse teknikisht mund të thuhet se interesi përllogaritet në baza ditore, ai do të përfshihet në të ardhurat bruto vetëm kur një shumë vërtetë është paguar apo kredituar.

1.4 *Fitoret në lotari dhe në lojërat e fatit.* Të ardhurat nga këto fitore do të raportohen në periudhën tatimore në të cilën janë pranuar ose kredituar në llogarinë e fituesit..

Shembull:

Një person rregullisht luan në një institucion të lojërave të fatit. Institucioni hap një "llogari" për personin i cili mban një bilanc rrjedhës për fitoret nga lojërat e fatit dhe tërheqjet. Fitoret do të përfshihen në të ardhurat bruto kur ato të kreditohen në llogari, pavarësisht nëse personi në fakt i tërheq këto fonde nga kjo llogari apo jo.

Neni 4
Të Ardhurat e Liruara

1. Paragrafët 1.1 deri te 1.5 të nenit 8 të Ligjit parashikojnë lirim nga Tatimi në të Ardhurat Personale për pagat e paguar apo kredituar për personelin e huaj, përfaqësuesit e huaj, zyrtarët e huaj, etj. Termi *'i huaj'* përdoret për të definuar një individ i cili nuk është rezident i rregullt i Kosovës dhe i cili nuk është regjistruar në regjistrin e shtetasve që kërkohet të mbahet sipas ligjit nr. 03/L-034 "Për shtetësinë e Kosovës".

2. Paragrafi 1.4 i nenit 8 të Ligjit parashikon që lirimet nga Tatimi në të Ardhurat Personale do të zbatohen, mes tjerash, për pagat e pranuara nga zyrtarët e huaj dhe ata vendor të rekrutuar të *"institucioneve financiare ndër qeveritare ndërkombëtare të pranueshme dhe të autorizuara me ligj që veprojnë në Kosovë".* Ky lirim tatimor vlen vetëm për zyrtarët e institucioneve financiare ndër-qeveritare ndërkombëtare që kanë një marrëveshje zyrtare me Qeverinë e Kosovës, e cila i njeh lirimet e tilla të tatimit.

3. Për qëllimet e paragrafëve 1.10 dhe 1.11 të nenit 8 të Ligjit, shprehja *"tjerë nga personi vendor"* nënkupton kontraktorët e themeluar (vendosur) jashtë Kosovës që nuk janë të detyruar të regjistrohen në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë në Kosovë mirëpo të cilët janë të obliguar që të njoftojnë ATK në formë të shkruar se janë duke punuar në Kosovë.

3.1 Në qoftë se kontraktori jo vendor kryen aktivitete të tjera në Kosovë, përveç atyre në lidhje me organizatat e përmendura në këta paragrafë, ai duhet të regjistrohet në Kosovë në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe në ATK(në këtë të fundit , ose duke aplikuar për numër fiskal ose duke caktuar përfaqësuesin fiskal i cili do të jetë i detyruar për të gjitha tatimet e kontraktonit në Kosovë) dhe të ardhurat e krijuara nga këto aktivitete të tjera , përfshihen në të ardhurat bruto të tatimpaguesit.

3.2 Këta kontraktorë jo vendor, pavarësisht se a kanë aktivitete të tjera apo jo, janë gjithashtu përgjegjës (qoftë direkt apo nëpërmes të përfaqësuesit të tyre fiskal) për përmbushjen e çdo detyrim të aplikueshëm të tatimit në burim të parapara në Kapitullin IX të Ligjit.

4. Për qëllimet e paragrafit 1.11 të nenit 8 të Ligjit, shprehja *"Organizatat Ndërkombëtare Ndër qeveritare"* nënkupton:

4.1 Korporatën Ndërkombëtare të Financave (IFC) dhe anëtarët tjerë tëGrupit të Bankës Botërore;

4.2 Banka Ndër-Amerikane për Zhvillim (IADB),
4.3 Banka Aziatike për Zhvillim (ADB);
4.4 Banka Afrikane për Zhvillim (AFDB);
4.5 Banka Islamike për Zhvillim (IDB).

5. Paragrafi 1.18 i nenit 8 të Ligjit parasheh që shpenzimet e caktuara për trajnim, të paguara nga një punëdhënës për një të punësuar për të marr pjesë në një program zyrtar të trajnimit do të lirohen nga tatimi në të ardhurat personale nëse këto shpenzime nuk e tejkalojnë vlerën prej një mijë euro (1000 €) në një periudhë tatimore.Shpenzimet për të cilat flet ky paragraf janë shpenzime aktuale të vetë programit të trajnimit duke përjashtuar ato shpenzime që kanë ndodhur për të udhëtuar për në kursin e trajnimit dhe duke përjashtuar ato shpenzime që kanë ndodhur për jetesë gjatë kursit të trajnimit (të cilat janë mbuluar në paragrafin 1.20 të nenit 8 të ligjit)

6. Paragrafi 1.20 i nenit 8 të Ligjit parashikon se *"shpenzimet për jetesë gjatë kohës së ndjekjes së një programi formal të trajnimit do të jenë të lejuara deri në një maksimum të caktuar nga Ministri në një akt nën-ligjor"*. Për qëllimet e këtij paragrafi, shumat maksimale te shpenzimeve të jetesës në dispozicion për lirim nga tatimi mbi të ardhurat personale do të jenë:

6.1. Në rastin e strehimit që është domosdoshmërish e nevojshme për shkak të largësisë të vendit të programit të trajnimit nga rezidenca kryesore e personit, ose për shkak të kërkesave për pjesëmarrje në programin e trajnimit:

6.1.1 strehimi brenda Kosovës 50 euro në ditë,

6.1.2 për strehim jashtë Kosovës, shumat ditore për shpenzimet për strehim të pagueshme sipas nenit 12 të Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Shërbimeve Publike nr.MSHP 2004/07 që lidhen nga shteti ku është bërë strehimi,

6.2 Në rastin e ushqimit:

6.2.1 programet e trajnimit brenda Kosovës 15 euro për ditë për programet ditore të trajnimit ose 25 euro për ditë për programet e trajnimit (me fjetje)

6.2.2 programet e trajnimit jashtë Kosovës, shuma ditore për shpenzimet e ushqimit të pagueshme sipas nenit 12 të Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Shërbimeve Publike nr. MSHP 2004/07 që mvaren nga shteti ku janë siguruar ushqimet.

6.3 Kur shpenzimet e jetesës në çdo periudhë tatimore tejkalojnë këto shuma, teprica do të konsiderohet si e ardhur e tatueshme e punonjësit dhe i nënshtrohet mbajtjes në burim në përputhje me dispozitat e Ligjit.

7. Paragrafi 1.21 i nenit 8 të Ligjit kërkon që llojet e shpenzimeve për trajnime të cilat kualifikohen për lirim nga tatimi mbi të ardhurat personale sipas nenit 8 do të specifikohen në një akt nën-ligjor. Ky paragraf ka të bëjë me shpenzimet e trajnimit që kualifikohen për lirim sipas paragrafit 1.18 të nenit 8 të ligjit që parashikon se lirimi vlen për *"shpenzimet e trajnimit të paguara nga një punëdhënës për një të punësuar për të marrë pjesë në programet formale të trajnimit për të fituar aftësitë themelore të nevojshme për punonjësin për të kryer detyrat e përcaktuara, ose të nevojshme për të siguruar aftësitë e freskuara që janë të lidhura me punën, për të punësuarin* ". Shpenzimet e trajnimit të paguara nga një punëdhënës për të marrë pjesë në programet e trajnimit për të arritur ose freskuar aftësitë që nuk janë të nevojshme për punën e të punësuarit (trajnim për shembull në një gjuhë të huaj që nuk përdoret në vend të punës) nuk do të kualifikohen për lirim. Paragrafi 1.21 i nenit 8 të ligjit më tej parashikon se shpenzimet e trajnimit që kualifikohen për lirim gjithashtu nuk do të përfshijë edhe shumat e barabarta me rrogat dhe pagat që paguhen për fillestarët ose nxënësit.

Neni 5
Të Ardhurat nga Pagat

1. Paragrafi 1.8 i nenit 9 të Ligjit parashikon që të ardhurat bruto nga pagat do të përfshijnë "përfitime në gjërat e dhëna nga një punëdhënës për një të punësuar që tejkalojnë shumën minimale të përcaktuara në një akt nën-ligjor të nxjerrë nga Ministri". Për qëllimet e këtij paragrafi, shuma minimale e përfitimeve në gjërat, mbi të cilën shumë përfitimet e tilla do të konsiderohen si të ardhura bruto nga paga do të jetë gjashtë dhjetë e pesë (65) euro në muaj. Për shembull, nëse një i punësuar merr nga punëdhënësi kryesor përfitime në natyrë prej 90 € / muaj, shuma prej 25 euro, e cila e kalon shumën e minimumit të caktuar prej 65 euro, do të përfshihet në të ardhurat bruto nga pagat.

2. Paragrafi 2.1 i nenit 9 të Ligjit parashikon që të ardhurat bruto nga pagat nuk do të përfshijnë *"rimbursimin e shpenzimeve aktuale të udhëtimit të biznesit deri në shumat që do të specifikohen në një akt nën-ligjor të nxjerrë nga Ministri"*. Për qëllimet e këtij paragrafi, shpenzimet e udhëtimit për biznes përfshijnë transportin, strehimin dhe ushqimin për udhëtimet afariste, por nuk përfshij shtesat për vajtje ardhje në dhe nga vendi i punës e punës. Duhet të plotësohen kushtet e mëposhtme për t'u kualifikuar për shpenzimet të udhëtimit për biznes(punë):

2.1 udhëtimi për punë duhet të ketë qenë i autorizuar me shkrim nga niveli përkatës i menaxhmentit;

2.2 qëllimi i udhëtimit të biznesit duhet të deklarohet në mënyrë të qartë;

2.3 kërkesa për udhëtim duhet t'i dorëzohet punëdhënësit në pajtim me politikat e punëdhënësit për shtesa për udhëtim;

2.4 shuma e rimbursueshme për strehim duhet të jetë brenda limitit të caktuar në dokumentin e punëdhënësit për politikat e shtesave për udhëtim. Për qëllime tatimore ajo nuk duhet të jetë më e lartë se 50 euro për strehim brenda Kosovës, dhe për strehim jashtë Kosovës nuk duhet të jetë më e lartë se shuma ditore e shpenzimeve për strehim të pagueshme sipas nenit 12 të Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Shërbimeve Publike Nr. MSHP 2004/07 e cila mvaret nga shteti ku është siguruar strehimi,

2.5 shuma e rimbursueshme për transport brenda Kosovës duhet të jetë kostoja aktuale e transportit publik ose një shumë e arsyeshme për kilometër e paraqitur në dokumentin e punëdhënësit për politikat e shtesave për udhëtim

nëse i punësuari e shfrytëzon automjetin e saj/atij. Për qëllime tatimore duhet të mos jetë më e lartë se 16 cent / kilometër. Për udhëtimet jashtë Kosovës nuk zbatohen kufizime me kusht që Fatura/bileta e transportit të jetë në dispozicion për inspektim nga Administrata Tatimore e Kosovës.

2.6 shuma e rimbursueshme për ushqim duhet të jetë shuma e caktuar për mëngjes, drekë apo darkë e paraqitur në dokumentin e punëdhënësit për politikat e shtesave për udhëtim . Për qëllime tatimore për udhëtimet brenda Kosovës nuk duhet të jetë më i lartë se 15 euro në ditë për udhëtim ditor ose 25 euro për udhëtime që kërkojnë qëndrimin gjatë natës brenda Kosovës, dhe për udhëtime jashtë Kosovës nuk duhet të jet më e lartë se shuma ditore e shpenzimeve të ushqimit e pagueshme sipas nenit 12 të Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Shërbime Publike me Nr. MSHP 2004/07 e cilat varet nga shteti ku është siguruar ushqimi;

2.7 shpenzimet e udhëtimit për biznes duhet të jenë plotësisht të regjistruara në librat e llogarisë së punëdhënësit;

2.8 kur rimbursimet tejkalojnë kufijtë monetar të specifikuar më lartë, teprica do të konsiderohet si e ardhur e tatueshme e punonjësit dhe i nënshtrohet mbajtjes në burim në përputhje me dispozitat e ligjit.

3. Për qëllime të paragrafëve 2.5 dhe 2.6 të nenit 9 të Ligjit duhet të plotësohen kërkesat e raportimit si në vijim:

3.1 udhëtimit shtëpi / punë të duhet të ketë qenë i autorizuar me shkrim nga ana e nivelit të menaxhmentit përkatës;

3.2 kërkesa e udhëtimit duhet t'i dorëzohet punëdhënësit në pajtim me politikat e punëdhënësit për shtesat për udhëtim;

3.3 fatura/bileta e transportit duhet të jetë në dispozicion për inspektim nga Administrata Tatimore e Kosovës;

3.4 shpenzimet e udhëtimit, duhet të jenë plotësisht të regjistruara në librat e llogarive të punëdhënësit.

Neni 6
Zbritja e Shpenzimeve

Paragrafi 3 i nenit 15 të Ligjit parasheh se nuk do të lejohen zbritje për çdo shpenzim të përllogaritur për të ardhurat të cilat i nënshtrohen mbajtjes së tatimit në burim përveç nëse ky shpenzim është paguar më ose para 31 Marsit të vitit vijues:

Shembull:

Një ndërmarrje personale e biznesit që e ka qarkullimin prej më shumë se 50.000 euro (pra llogarisin për tatim në të ardhura në baza “reale”) i jep me qira lokalet e saj .Në fund të vitit 2010 i ka borxh qiradhënësit 3000 euro për 3 muaj qira deri më 31 dhjetor 2010. Nëse qiradhënësi qiradhënien nuk e ka biznes,atëherë qiradhënësi mundë të regjistrojë vetëm të ardhurat nga qiraja kur janë pranuar ato,dhe paguesit e qirasë mundë të kërkojnë shpenzimet e qirasë vetëm kur të jetë paguar qiraja- në këtë rast neni 15 nuk aplikohet meqë ai aplikohet vetëm lidhur me shpenzimet e

përllogaritura. Nëse qiradhënësi e ka biznes qiranë dhe mundë të kërkojnë të ardhurat nga qiraja në baza aktuale, atëherë paguesi i qirasë gjithashtu mundë të kërkojë shpenzimet e qirasë në baza aktuale. Nëse qiraja e përllogaritur paguhet më ose para 31 Marsit 2011, do të lejohet zbritja e kërkuar e shpenzimeve të qirasë në periudhën tatimore 2010 për tre muajt e fundit . Mirëpo nëse kjo qira nuk është paguar deri më 31 mars 2011 atëherë ndërmarrja personale e biznesit nuk do të jetë në gjendje që të kërkojë qiranë e përllogaritur në periudhën tatimore 2010. Kjo qira do të jetë në gjendje të kërkohet vetëm si shpenzim në periudhën tatimore (2011 ose më vonë) kur qiraja është paguar në të vërtetë.

Neni 7
Zbritja e Shpenzimeve të Udhëtimit për Punë

Paragrafi 2 i nenit 18 të këtij Ligji i referohet limiteve të zbritjeve në dispozicion për shpenzimet e udhëtimit.Limitet që do të aplikohen janë të njëjta sikurse ato që janë paraqitur në paragrafin 2 të Nenit 5 të Këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 8
Tatimet e Mbajtura në Paga

1. Paragrafi 2 i nenit 38 të Ligji kërkon që punëdhënësit të cilët janë punëdhënësi kryesor i të punësuarit të mbajnë në burim një shumë të tatimit për periudhën përkatëse të pagesave të pagave, në përputhje me normat e përcaktuara në nenin 6 të këtij ligji.

1.1 Çdo tatim tentativë për një muaj të caktuar do të zvogëlohet për shumën e mbajtur nga ana e punëdhënësit kryesor për muajin e mëparshëm në vit". Për zbatimin e kësaj dispozite për personat të cilët presin të kenë një punëdhënës kryesor gjatë vitit tatimor, shuma e pagueshme për çdo periudhë të pagesës duhet të ngritët deri në një bazë vjetore, duke u bazuar në numrin e periudhave të pagesës në vitin tatimor, para se të aplikohen shumat vjetore të paraqitura në nenin 6 të këtij ligji.

1.2 Tatimi vjetorë për t'u paguar i llogaritur në këtë mënyrë më pas ndahet me numrin e njëjtë të periudhave të pagesës për të dhënë shumën që duhet të mbahet në burim për periudhën e pagesës. Personat të cilët nuk pranojnë që të kenë një punëdhënës kryesor gjatë vitit tatimor (p.sh personat që hyjnë në punë pas përfundimit të edukimit të plotë,personat të cilët janë larguar nga puna dhe nuk kanë gjetur punë tjetër,personat që presin të pensionohen ose të ndërprejnë në ndonjë mënyrë tjetër marrëdhënien e punësimit gjatë vitit,etj) munden pas 1 Janarit 2011 të plotësojnë Formularin e Aplikacionit për Normë të Veçantë Tatimore (në formatin e përcaktuar nga ATK), dhe aplikojnë në ATK që nga punëdhënësi i tyre kryesor të zbatohet normë speciale tatimore që sa më saktësisht të harmonizoj zbritjet e tatimit të mbajtur në burim me shumën e tatimit për tu paguar nga i punësuari në baza vjetore**.**

Shembulli 1:

Një punëdhënës kryesor paguan një të punësuar 500 € në muaj. Meqë janë 12 periudha të pagesës gjatë vitit, paga vjetore e punonjësit do të jetë 6.000 € (500 x 12). Pas lejimit të zbritjes prej 5% nga bruto për kontributet pensionale për të punësuarin,

paga vjetore e tatueshme do të jetë 5700 euro. Mandej aplikohet paragrafi 1.4 i nenit 6 i cili parashikon që tatimi vjetor për tu paguar mbi këtë shumë do të jetë 273.60 € + 10% e shumës mbi 5.400 € (5.700 - 5.400 = 300 x 10% = 30 euro), duke i dhënë një total prej 303.60 €. Kjo shumë mandej ndahet me numrin e periudhave të pagesës (12) që rezulton në 25.30 € e cila kërkohet që të ndalet në burim nga shuma bruto 500 €. Së bashku me kontributet pensionale prej 25 euro (5% të 500 eurove) i punësuari do të pranojë pagën neto prej 449.70 euro (500 - 25 euro kontribute pensionale të mbajtura dhe pa 25.30 euro tatim të mbajtur në paga).

Shembulli 2:

Të njëjtat fakte sikurse në Shembullin 1 me përjashtim se tani është muaji vijues dhe Punëdhënësi ka vendosur që të paguaj të punësuarin me një pagë më të madhe prej 550 euro për atë muaj. Në këtë rast shuma vjetore llogaritet si 6.600 euro (fakti se i punësuari ka pranuar pagën bruto prej 500 euro në muajin e mëparshëm është jo relevant) ku pas kontributeve pensionale të të punësuarit prej 5% tregon një pagë të tatueshme vjetore prej 6270 euro. Mandej zbatohet paragrafi 1.4 i Nenit 6 dhe ky parasheh se tatimi vjetor i pagueshëm do të jetë 273.60 + 10% e shumës mbi 5400 euro (6270- 5400 x 10% = 87 euro që e jep totalin prej 360.60. Duke e pjesëtuar me numrin e periudhave të pagesave (12) rezulton në 30.5 euro e kërkuar për tu mbajtur në burim nga 550 euro),i punësuari do të pranoj pagën neto prej 492.45 euro (550 – 27.50 kontribute pensionale të mbajtura në burim dhe pa 30.5 euro tatim në burim në paga).

Në muajin e tretë, nëse punëdhënësi vazhdon të paguaj të punësuarin me pagën bruto 550 euro, atëherë i punësuari do të vazhdojë të pranojë 492.45 euro neto sikurse në shembullin 2. Mirëpo nëse punëdhënësi paguan vetëm 500 euro pagën bruto në muajin e tretë atëherë i punësuari do të pranoj 449.70 euro, neto sikurse në shembullin 1. Nuk bëhet ndonjë rregullim i asaj me të cilën i punësuari aktualisht është paguar në dy muajt e parë.

Shembulli 3:

Punëdhënësi kryesor paguan një të punësuar 200 euro për dy javë. (I vetmi dallim nga shembulli i mëparshëm është se i punësuari paguhet çdo dy javë e jo çdo muaj). Në këtë rast llogaritjet do të bazohen në 26 periudha të pagesës. Pra shuma prej 200 euro do të ngritët deri në vjetoren e barabartë me 5200 euro (200x 26). Pas zbritjes prej 5% të kontributeve pensionale, paga vjetore e tatueshme është 4940 euro. Në këtë rast,pastaj zbatohet paragrafi 1.3 i nenit 6 dhe ky parashikon se tatimi vjetor për tu paguar do të jetë 81.60 + 8% të shumës mbi 3000 euro (4,940-3000 x 8% = 155.20 euro) qe e jep totalin prej 236.80 euro. Duke e pjesëtuar me numrin e periudhave të pagesës (26) rezulton në 9.10 euro të cilat kërkohen për tu mbajtur në burim nga 200 euro të shumës bruto të pagueshme. Së bashku me kontributet pensionale prej 10 euro (5% prej 200 euro) i punësuari do të pranojë pagën neto prej 180.90 euro (200 – 10% kontribute pensionale të mbajtura në burim dhe pa 9.10 euro tatim të mbajtur në burim në paga).

Shembulli 4:

Një student i universitetit përfundon studimet e tij në fund të vitit akademik dhe fillon punë që nga fillimi i tetor me një pagë prej 400 euro në muaj. Duke përdorur metodën e normave të mbajtjes të tatimit në burim të përshkruara në këtë paragraf, punëdhënësi do llogaritë pagesën vjetore bruto për gjithë vitin deri në një shumë bruto prej 4800 €, zbret 5% kontribute pensionale të të punësuarit për të arritur në një pagë vjetore të tatueshme prej 4560 €, dhe llogarit ndaljen e tatimit mujor prej 10.40 € (4560 - 3000 x 8%) / 12. Për 3 muajt e fundit të vitit i punësuari merr 1.200 € dhe ka tatimin total të mbajtur në burim prej 31.20 €. Megjithatë, detyrimi tatimor vjetor i tyre (duke supozuar se nuk ka të ardhura të tjera të tatueshme) në 1200 euro të ardhura është vetëm 9.60 € (1200 - 960 x 4%) kështu që personi nuk do të jetë në gjendje të kërkojë rimbursim tatimor prej 21.60 €. Përndryshe, personi (nga 1 janari 2011) ka mund të aplikoj për një normë tatimore të veçantë që ATK do të kishte llogaritur në këtë rast me 0,8% që do të thotë tatimi i mbajtur për çdo muaj do të kishte qenë vetëm 3.20 euro,(400 x 0,8%) dhe si rezultat tatimi i mbajtur gjatë tre muajve të punësimit do të jetë 9.60 € që harmonizohet me detyrimet vjetore.

2. Paragrafët 1 dhe 4 i nenit 38 të Ligjit kërkojnë që pagesat e pagave dhe pensioneve ti nënshtrohen tatimit në burim. Pagat e tatueshme apo pensionet e paguara / krediturara një person i cili është i liruar nga Tatimi në të Ardhurat Personale sipas nenit 8 të Ligjit, sipas çdo ligji tjetër të Kosovës, ose sipas një marrëveshje / konvente ndërkombëtare, nuk do t'i nënshtrohet mbajtjes në burim. Në raste të tilla, barra i takon marrësit te pagave apo pensioneve për të siguruar dëshmi të shkruara për paguesin që të ardhurat e tij janë të liruara nga tatimi mbi të ardhurat personale. Deri sa të sigurohet një dëshmi e tillë, detyrimi mbetet në paguesin që të mbaj në burim.

3. Dëshmia me shkrim që kërkohet sipas paragrafit 2 të këtij neni do të jetë:

3.1 në rast të personave të liruar nga tatimi mbi të ardhurat personale sipas paragrafëve 1.10 apo 1.11 të nenit 8 të ligjit, një kopje e kontratës së tyre,

3.2 në çdo rast, tjetër nga rasti i pagave dhe pensioneve që janë të liruara nga tatimi në të ardhurat personale sipas paragrafëve 1.1,1.2,1.3,1.4,1.5 ose 1.14 të nenit 8 të ligjit (ku nuk ka nevojë për evidencë me shkrim), një kopje e një letre nga ATK duke konfirmuar lirimin nga tatimi mbi të ardhurat personale.

4. Për qëllime të pagesës së tatimit të mbajtur në pagat e tatueshme dhe pensionet sipas këtij neni, mbajtësit në burim do të përfundojnë mbajtjen e tatimit dhe formularin e deklarimit të pagesës ashtu siç përshkruhet nga ATK dhe do t'i dorëzojë formularët dhe pagesat në një bankë ose institucion financiar të licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës.

5. Punëdhënësit të cilët paguajnë paga më shpesh se një herë në muaj janë të detyruar që të mbajnë tatimin në burim nga këto paga në çdo periudhë të pagesës, mirëpo janë të detyruar vetëm që të plotësojnë një formular të mbajtjes në tatim dhe të pagesës dhe paguajnë tatimin e mbajtur në burim një herë lidhur me çdo muaj. Punëdhënësit të cilët dëshirojnë të mbajnë në burim dhe të paguajnë tatim më shpesh se një herë në muaj mund të bëjnë një gjë të tillë duke plotësuar pasqyrën shtesë të mbajtjes në burim dhe pagesës mirëpo duhet të tregojnë nëse formularët e dytë apo pasues për të njëjtin muaj janë një korrigjim apo një pagesë shtesë për atë muaj.

Neni 9
Mbajtja e Tatimit në Burim në Interes dhe në të Drejtat Pronësore (Rojaltis)

1. Paragrafi. 1 i nenit 39 të Ligjit kërkon që të mbahet tatimi në burim nga pagesat e interesit dhe të drejtave pronësore. Interesi ose të drejtat pronësore të paguara apo krediuara një person i cili është i liruar nga Tatimi në të Ardhurat Personale sipas nenit 8 të ligjit, apo ndonjë ligji tjetër të Kosovës, ose sipas një marrëveshje / konvente ndërkombëtare, nuk do ti nënshtrohet tatimit në burim. Në raste të tilla, është përgjegjësia e marrësit të interesit dhe të drejtave pronësore që të ofrojë dëshmi me shkrim për paguesin që të ardhurat e tyre janë të liruara nga tatimi në të ardhurat personale. Derisa të sigurohet një dëshmi e tillë , detyrimi mbetet në paguesin që të mbajë në burim.
2. Dëshmitë me shkrim që kërkohen sipas paragrafit 3 të këtij neni do të jenë:

2.1 në rastin e personave të liruar nga Tatimi në të Ardhurat Personale sipas paragrafëve 1.10 apo 1.11 të nenit 8 të ligjit, një kopje e kontratës së tyre;
2.2 në çdo rast tjetër, një kopje e një letre nga ATK e cila konfirmon lirimin nga Tatimi në të Ardhurat Personale.

Neni 10
Mbajtja e Tatimit në Burim në Fitimet e Lotarisë dhe Lojërave të Fatit

[Shënim: Ky nen i Udhëzimit Administrativ, për aq sa lidhet me lojërat e fatit, do të dal nga përdorimi kur të hyjë në fuqi Ligji i ri për Lojërat e fatit dhe Lotarinë, në pajtim me paragrafin 2 të nenit 49 të ligjit.]

1. Paragrafët 1 dhe 2 të nenit 40 të Ligjit kërkojnë që pagesat e fitoreve të lotarisë dhe lojërave të fatit ti nënshtrohen mbajtjes së tatimit në burim. Lotaria, ose loja e fatit, fitimet e paguara apo krediuar një personi i cili është i përjashtuar nga tatimi mbi të ardhurat personale sipas nenit 8 të Ligjit, sipas çdo ligji tjetër të Kosovës, ose sipas një marrëveshje ose konvente ndërkombëtare, nuk do ti nënshtrohet tatimit në burim. Në raste të tilla, barra i bie pranuesit të fitimeve që të siguroj dëshmi të shkruara për paguesin se të ardhurat e tyre janë të liruara nga tatimi mbi të ardhurat personale. Deri sa të sigurohet një evidencë e tillë , detyrimi bie në paguesin që të mbaj tatimin në burim.

2. Dëshmitë me shkrim që kërkohen sipas paragrafit 1 të këtij neni do të jenë:

2.1 në rast të personave të liruara nga tatimi mbi të ardhurat personale sipas paragrafëve 1.10 apo 1.11 të nenit 8 të Ligjit, një kopje e kontratës së tyre;
2.2 në çdo rast tjetër, një kopje e një letre nga ATK që konfirmon lirimin nga tatimi mbi të ardhurat personale;
2.3 vini re se përjashtimi nga Tatimi në të Ardhurat Personale i paraparë për fitimet nga Lojërat e fatit sipas paragrafit 1,13 të nenit 8 të Ligjit, vetëm hyn në fuqi në të njëjtën kohë kur tatimi i mbajtur në burim më nuk aplikohet për fitimet e Lojërave të fatit -kjo do të ndodhë kur të hyn në fuqi Ligji i ri për Lojërat e fatit dhe Lotarinë, në pajtim me paragrafin 2 të Nenit 49 të Ligjit.

3. Për qëllime të pagesës së tatimit të mbajtur në fitimet në lotari, apo lojëra të fatit sipas këtij neni, mbajtësit në burim do të plotësojnë formularin e pasqyrës së tatimit të mbajtur në burim pagesës ashtu siç përcaktohet nga ATK, dhe do të dorëzojnë formularin dhe pagesën në një bankë ose institucion financiar të licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës.

Neni 11
Mbajtja e Tatimit në Burim për Jo-Rezidentë të Caktuar

1. Paragrafët 1 dhe 2 të nenit 41 të Ligjit kërkojnë që mbajtja e tatimit në burim nga të ardhurat e atribuara për zbavitësit jo-rezident dhe për jo-rezidentët të cilët kryejnë shërbime në Kosovë. Kur këto të ardhura i paguhen apo i kreditohen një personi jo-rezident ose entiteti i cili është i liruar nga tatimi mbi të ardhurat personale sipas nenit 8 të Ligjit, sipas ndonjë ligji tjetër të Kosovës, ose sipas një marrëveshje ose konvente ndërkombëtare, këto të ardhura nuk do ti nënshtrohen tatimit të mbajtur në burim. Në raste të tilla, është përgjegjësia e pranuesit të të ardhurave që të sigurojë dëshmi me shkrim për paguesin se të ardhurat e tyre janë të liruara nga Tatimi në të Ardhurat Personale. Deri sa të sigurohet një dëshmi e tillë, detyrimi mbetet në paguesin që të mbajë tatimin në burim.
2. Dëshmitë me shkrim që kërkohen sipas paragrafit 1 të këtij neni do të jenë:

2.1 në rastin e personave të liruara nga tatimi mbi të ardhurat personale sipas paragrafëve 1.10 apo 1.11 të nenit 8 të Ligjit, një kopje e kontratës së tyre;

2.2 në çdo rast tjetër, një kopje e një letre nga ATK e cila konfirmon lirimin nga tatimi mbi të ardhurat personale.

3. Të ardhurat e atribueshme për jo-rezidentët të cilat i nënshtrohen mbajtjes së tatimit në burim sipas nenit 38 të Ligjit gjithashtu nuk do ti nënshtrohen mbajtjes së tatimit në burim në bazë të nenit 41 të këtij Ligji. Në këto raste aplikohet vetëm mbajtja në burim e tatimit sipas nenit 38.

4. Të ardhurat e atribueshme për zbavitësit jo-rezidentë sipas paragrafit 1 të nenit 41 të ligjit, të cilat janë paguar apo kredituar në ndonjë rast tjetër nga ato që mbulohen nga paragrafët 1 dhe 3 i këtij neni, do t'i nënshtrohen mbajtjes në burim përveç nëse kompensimi bruto nga aktivitetet e tij apo të saj personale nga të gjithë paguesit e aktiviteteve të tilla nuk e ka tejkaluar vlerën prej një mijë (1.000) euro në një periudhë tatimore. Në situatat kur paguesi nuk është i sigurt nëse kompensimi bruto i artistit nga aktivitetet e tij apo të saj personale gjatë periudhës tatimore do të tejkalojë 1,000 euro, paguesi është i detyruar të kërkojë nga artisti rreth kompensimi bruto të tij apo të saj të pritur dhe vetëm nëse artisti tregon që kompensimi i tyre bruto nga aktivitetet personale në periudhën e tatueshme do të jetë 1.000 € ose më pak, pagesat apo kreditimet nuk do ti nënshtrohen tatimit në burim.

5. Kërkesa për të mbajtur tatimin në burim nga të ardhurat e atribueshme për zbavitësit jo- rezident në bazë të paragrafit 1 të nenit 41 të Ligjit ka të bëjë me aktivitetet personale të artistit që janë ushtruar në Kosovë. Pagesat për artistin jo-rezident që nuk janë në lidhje me aktivitetet e tyre personale (p.sh nga shitjet e mallrave) nuk i nënshtrohen mbajtjes së tatimit në burim. Pagesave nga Kosova për

aktivitetet personale të ushtruara jashtë Kosovës gjithashtu nuk i nënshtrohen mbajtjes së tatimit në burim.

Shembull:

Një artist jo rezident viziton Kosovën dhe fiton para nga shfaqja në Prishtinë dhe në Prizren. Artisti gjithashtu fiton para nga shitjet e CD-ve të muzikës së tyre dhe nga shitjet e mallrave të tjera. Tatimi në burim aplikohet vetëm për parat e paguara artistit për shfaqjet. Parat nga shitjet e mallrave nuk është në relacion me aktivitetin personal të artistit.

6. Kërkesa për të mbajtur tatimin në burim nga të ardhurat e atribueshme për zbavitësit jo- rezident në bazë të paragrafit 1 të nenit 41 të ligjit ka të bëjë me të ardhurat që i atribuohen (qoftë të paguara në para të gatshme apo natyre, ku këto të fundit do të vlerësohen me vlerën e hapur të tregut) artistit qoftë të paguara në mënyrë direkte ose indirekte. Mbajtja e tatimit në burim gjithashtu kërkohet kur artisti paguhet në mënyrë të tërthortë, për shembull kur pagesa është bërë për një korporate apo person tjetër juridik, e cila mbahet 100% nga artisti ose që është në pronësi tjetër të përfitimit nga artisti në vend se drejtpërdrejt për artistin.

7. Kërkesa për të mbajtur tatimin në burim nga të ardhurat e paguara për jo-rezidentët sipas paragrafit 2 të nenit 41 të Ligjit ka të bëjë me pagesat për shërbimet e kryera në Kosovë. Nuk kërkohet mbajtja e tatimit në burim në pagesat e bëra për jo-rezidentët për mallra ose nga pagesat e bëra për jo-rezidentët për shërbimet e kryera jashtë Kosovës (për shembull shërbimet e transportit ndërkombëtar, mbështetjen e sistemit kompjuterik të siguruar nga distanca nga një vend tjetër). Duhet të bëhet një shpërndarje kur shërbimet kryhen brenda dhe jashtë Kosovës me përjashtim për rastet kur shërbimet e kryera në një shtet dhe shërbimet e kryera në shtetin tjetër janë shumë të vogla .

Shembull:

Biznesi i Kosovës hyn në kontratë me furnizuesin jo-rezident për të dizajnuar softuerin kompjuterik për shfrytëzim nga biznesi i Kosovës. E gjithë puna e dizajnimit dhe testimit kryhet jashtë Kosovës. Mirëpo përfaqësuesi i furnizuesit kërkohet që të vizitojë Kosovën për tu siguruar se softueri është instaluar si duhet. Në këto rrethana vizita e instalimit do të konsiderohet si pjesë shumë e vogël në krahasim me punën kryesore të dizajnimit të softuerit,dhe meqë kjo është kryer jashtë Kosovës,nuk do të aplikohet mbajtja e tatimit në burim për pagesat për furnizuesit jo-rezident. Për dallim nga kjo nëse furnizuesi më pas ka hyrë në kontratë për mirëmbajtje për softuer e cila ka paraparë disa testime të sistemit jashtë Kosovës, mirëpo gjithashtu disa vizita në vend në Kosovë, atëherë do të aplikohet mbajtja e tatimit në burim për shpenzimet e kontratës së mirëmbajtjes lidhur me atë pjesë të shpenzimeve që lidhen me punën e vizitës në vend të punës

8. Kërkesa për të mbajtur tatimin në burim nga të ardhurat sipas paragrafëve 1 dhe 2 të nenit 41 të Ligjit vlen vetëm për ata që konsiderohen si jo-rezident për qëllimet tatimit në të ardhurat personale. Për artistët persona fizik të cilët e kanë vendbanimin e tyre kryesorë në Kosovë apo që janë fizikisht në Kosovë për më shumë se 183 ditë

në çdo periudhë 12-mujore, mbajtja e tatimit në burim nuk duhet të zbatohet meqë artistët do të konsiderohen si rezidentë dhe do ti nënshtrohen tatimit në të ardhurat e tyre në mbarë botën. Kërkesa për të mbajtur tatimin në burim nga të ardhurat e paguara për jo-rezidentët sipas paragrafit 2 të nenit 41 të ligjit gjithashtu vlen për personat fizik jo rezident të cilët zhvillojnë biznes mirëpo të cilët nuk kanë njësi të përhershme në Kosovë.

8.1 Paragrafi 4 i nenit 31 të Ligjit parasheh se në të dy rastet " *mbajtja në burim sipas këtij neni do të konsiderohet tatim i fundit dhe pranuesit e këtyre të ardhurave që i nënshtrohen tatimit në burim nuk do të dorëzojnë deklaratë në administratën tatimore, pavarësisht nga dispozitat e nenit 34 të këtij ligji.* Tatimi në burim prej 5% do të jetë obligimi i tyre i fundit për tatim në të ardhurat personale në Kosovë dhe këta nuk janë të lejuar që të dorëzojnë deklaratë vjetore për tatim në të ardhura personale për të kërkuar mbajtjet në burim duke u bazuar në atë se nuk janë të obliguar për tatim në të ardhurat personale në Kosovë sepse këta nuk kanë këtu njësi të përhershme.

9. Për qëllim të pagesës së tatimit të mbajtur në burim në të ardhurat e referuar në parafin 1 dhe 2 të nenit 41 të Ligjit, paguesit do të plotësojnë formulari e pasqyrës së mabjtjës së tatimit në burim dhe pagesës të përcaktuar nga ATK-ja, dhe do të dorëzojnë formularin dhe pagesën në bankën ose institucionin financiar të licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës.

10. Për qëllime të këtij neni, termi "paguesi" nënkupton çdo person ose entitet, qoftë organizatë ose individ, i cili ka rënë dakord të paguajë një person jo-rezident ose entitet për argëtim apo shërbime të tjera të kryera në Kosovë.

Neni 12
Dispozitat e Përgjithshme që Zbatohen për Tatimin e Mbajtur në Burim

1. Kapitulli IX i Ligjit parasheh që tatimet e mbajtura në burim duhet të paguhen në një bankë ose institucion financiar të licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës. Transferimi bankar mund të bëhet në vend të pagesës me para të gatshme. Këto pagesa (duke përfshirë të urdhrat për transferimin të parave për transferime bankare) mund të dorëzohen në çdo degë te të një banke ose institucioni financiar të autorizuar që i pranon ato. Përveç në rastet kur nga Drejtori i Përgjithshëm i ATK-s caktohen zyrtarë tatimor të caktuar për të mbledhur tatimin sipas ligjit mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat këto pagesat nuk do të dorëzohen në çdo zyrë apo te çdo zyrtar i ATK-s.

2. Pagesat e referuara në paragrafin 1 të këtij neni duhet të shoqërohen nga pasqyra e mbajtjes në burim. Pasqyra e mbajtjes në burim do të jetë:

2.1 për ata mbajtës të tatimit në burim të cilët dëshirojnë të deklarojnë dhe janë në gjendje të deklarojnë informatat e tyre të tatimit të mbajtur në burim në ATK në mënyrë elektronike, një dëftesë e pagesës së tatimit të mbajtur në burim.

2.2 për mbajtësit tjerë të tatimit në burim, formularin e plotësuar të pasqyrës së tatimit të mbajtur në burim dhe pagesës siç do të përcaktohet nga ATK.

3. Kapitulli IX i Ligjit parasheh se pasqyrat vjetore të barazimit, së bashku me kopjet e certifikatave të mbajtjes së tatimit në burim, kërkohet që ti sigurohen Administratës Tatimore. Pasqyrat dhe certifikatat e tilla mund të sigurohen në çdo zyrë të Administratës Tatimore të Kosovës apo në çdo degë të një banke ose institucion financiar të autorizuar që i pranon ato.

4. Kapitulli IX i Ligjit parasheh data të caktuara në të cilat tatimet e mbajtura në burim duhet të paguhen, certifikatat e tatimeve të mbajtura në burim duhet ti jepen pranuesve, dhe mbajtësit në burim janë të obliguar që të sigurojnë pasqyrën vjetore të barazimit për Administratën Tatimore. Në çdo rast, kur data e veçantë për deklarim dhe / ose pagesë është e shtunë,e diele apo festë zyrtare, këta formular dhe / ose pagesa duhet të dorëzohen më së voni në ditën e parë të punës pas së shtunës, dielës apo festës zyrtare. Interesi dhe dënimet për deklarim me vonesë ose pagesë nuk do të zbatohen kur deklarimi dhe / ose pagesa bëhet më herët ose në ditën e ardhshme të punës.
5. Kapitulli IX i Ligjit parasheh kërkesa të ndryshme për deklarim dhe pagesa për mbajtësit në burim dhe paguesit. Kur këto kërkesa nuk plotësohen, ATK do të zbatoj interesin dhe ndëshkimet administrative sipas Ligjit mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, si të aplikueshme për:

5.1 dështimin për të mbajt në burim, mbledhur ose paguar tatimin e mbajtur në burim,
5.2 dështimin për të siguruar pranuesin e të ardhurave që i nënshtrohen mbajtjes së tatimit në burim me certifikatën e mbajtjes së tatimit në burim,
5.3 dështimi për të deklaruar pasqyrën vjetore të barazimit në ATK-së në afatin e caktuar,
5.4 deklarimi i pasqyrës së pasaktë ose të paplotë vjetore të barazimit në ATK .

Neni 13
Pagesat Tremujore të Paradhënieve të Aktivitetit Ekonomik

1. Në përputhje me paragrafin 2.1 të nenit 43 të Ligjit, tatimpaguesit me të ardhura vjetore bruto prej 50,000 euro ose më pak dhe ata që nuk zgjedhin të përgatisin pasqyrat financiare janë të obliguar për të bërë pagesat tremujore të paradhënieve për tatimin mbi të ardhurat personale.Tatimpaguesit e tillë do të dorëzojnë pagesa tremujore të paradhënieve për formularët e bizneseve të vogla individuale në formatin e përshkruar nga ATK,në çdo bankë apo institucion financiar të autorizuar në ose përpara 15 prillit, 15 korrikut, 15 tetorit dhe 15 janarit në lidhje me tremujorët kalendarik që i paraprijnë menjëherë këtyre datave.

2. Në përputhje me paragrafin 2.2 të nenit 43 të Ligjit, tatimpaguesit me të ardhura vjetore bruto që tejkalojnë 50,000 euro dhe ata që zgjedhin të përgatisin pasqyrat financiare janë të obliguar për të bërë pagesat tremujore të paradhënieve për tatimin mbi të ardhurat personale.Tatimpaguesit e tillë, dhe kompanitë e sigurimit, do të dorëzojnë pagesa tre mujore të paradhënieve për formularët e bizneseve individuale të mëdha në formatin e përshkruar nga ATK në çdo bankë apo institucion financiar të autorizuar në ose përpara 15 prillit, 15 korrikut, 15 tetorit dhe 15 janarit në lidhje me tremujorët kalendarik që ju paraprijnë menjëherë këtyre datave.

3. Tatimpaguesit e mbuluar nga paragrafi 2.2 i nenit 43 të Ligjit janë të detyruar të përdorin bazat e parashikimit në vitin e tyre të parë të bërjes së pagesave tremujore të avancit dhe parashikimet bazohen në ¼ e detyrimit tatimor vjetor të parashikuar për vitin e parë. Për ata që fillojnë veprimtari ekonomike gjatë tremujorit të parë kjo nuk është problem, por për ata të cilët fillojnë më vonë në vit, ata kërkohet që të paguajnë vetëm ¾, ½ ose vetëm ¼ e detyrimit të tyre të vitit të parë në këste gjatë vitit të parë. Për vitin e tyre të dytë, duke bërë pagesa tremujore të avancit bazuar në detyrimin tatimor vjetor për aktivitetin e tyre ekonomik për vitin e tyre të parë., të rritura prej 10%, do të thotë nuk paguhet ndëshkimi me interes. Tatimpaguesit ku pagesat e paradhënieve të të cilëve janë të pamjaftueshme krahasuar me detyrimin tatimor final do të ndëshkohen vetëm për tremujorin e tyre të fundit të vitit të parë, por bazuar në shumat kumulative të kësteve krahasuar me detyrimin vjetor, e jo vetëm të konsiderohet kësti i fundit thjesht i izoluar. Në këto raste interesi dhe ndëshkimet do të aplikohet vetëm kur pagesat tremujore të bëra janë më të ulëta se 90% e detyrimit tatimor vjetor për aktivitetin e tyre ekonomik për vitin e parë të tyre. Për vitin e dytë dhe vitet tjera të më pasme meqë është në dispozicion opsioni i pagesës pa ndëshkime dhe interes, ata do të ndëshkohen për çdo këst tremujor nëse janë bërë pagesat e pamjaftueshme gjatë vitit.

Shembulli 1:

Një tatimpagues individual ka filluar një aktivitet ekonomik në vitin 2010. Ai ka paguar në 3 këste (tremujorët 2, 3 dhe 4), respektivisht 100 €, 200 € dhe 620 €. Detyrimi vjetor i tatimit mbi të ardhurat personale për vitin 2010 në lidhje me këtë aktivitet ekonomik rezulton të jetë 1.000 €. Në këtë rast, meqë të gjitha kështet (920 euro), ishin më shumë se 90% e detyrimit vjetor (90% e 1.000 = 900 euro) nuk aplikohet interesi dhe ndëshkimet (sipas paragrafi 3.3 të nenit 43 të Ligjit).

Shembulli 2:

Një tatimpagues individual ka filluar një aktivitet ekonomik në vitin 2010. Ai ka paguar në 2 këste (tremujorët 3 dhe 4), respektivisht 200 € dhe 500 €. Detyrimi vjetor i tatimit mbi të ardhurat personale për vitin 2010 në lidhje me këtë aktivitet ekonomik rezulton të jetë 1.000 €. Në këtë rast, meqë të gjitha kështet (700 euro) janë më pak se 90% e detyrimit vjetor (90% e 1.000 = € 900) interesi paguhet duke filluar nga 15 janar 2011 (data e afatit të tremujorit të kështit të fundit në lidhje me vitin tatimor 2010). Interesi i tillë është i bazuar në 300 €, diferenca mes detyrimit vjetor (1.000 euro) dhe kësteve kumulative të paguara gjithsej (700 euro)- dhe llogaritet prej 15 janar 2011 deri në datën e afatit për dorëzimin e deklaratës së fundit(31 mars 2011). Në këtë kohë interesi dhe ndëshkimi për nën-pagesën e pagesës së paradhënies përfundon mirëpo pastaj aplikohen ndëshkimet e rregullta lidhur me çdo periudhë ndërmjet kësaj date të afatit dhe derisa të paguhet tatimi.

4. Në rastet kur kështet e hershëm ishin shumë të ulëta dhe kështet e më vonshme shumë të larta, interesi dhe ndëshkimet do të aplikohen për kështet e mëhershme deri sa pagesat e tepërta të më vonshme të mbulojnë Mungesat e mëhershme. Në rastet kur kështet e mëhershme janë shumë të larta dhe ato të më vonshme janë shumë të ulëta, ATK do të pranoj tepricat në periudhat e mëhershme që mbulojnë mungesat në

periudhat e mëvonshme dhe interesi dhe ndëshkimet mund ose mund të mos aplikohen, varësisht nga shumat e tepricave dhe mungesave.

Shembull:

Në vitin 2010 biznesi i tatimpaguesit ka pasur një fitim dhe 1.000 € të tatimit mbi të ardhurat personale është e pagueshme në lidhje me këtë biznes. Për vitin 2011, një tjetër fitimi është bërë dhe 2.000 € janë tatim mbi të ardhurat personale për tu paguar (në vitin 2012). Gjatë vitit 2011 kështet tremujore janë bërë prej 600 euro, 100 €, nuk ka kësh, dhe 350 € . Bazuar në detyrimin vjetor të viti 2010 prej 1,000 euro dhe duke shtuar 10%, kështet tremujore gjatë vitit 2011 duhet të ketë qenë të paktën 275 € secila. Nuk ka ndëshkim me interes për tu paguar në lidhje me kështin e parë (meqë 600 euro pagesa e tejkalon 275 euro për t'u paguar). Nuk ka ndëshkim me interes për tu paguar në lidhje me kështin e dytë (meqë pagesa 100 € plus 325 euro (600 pa 275) tepricë nga kësti i parë e ka tejkaluar 275 euro për t'u paguar). Interesi për tu paguar në kështin e tretë do të bazohet mbi 125 € (që është 275 € për tu paguar pa 150 euro të mbetura (dy pagesa që gjithsej bëjnë 700 euro pa detyrimet për këto këste prej 550 euro) tepër nga tremujorët e mëparshëm). Nuk ka interes për tu paguar në kështin e katërt dhe teprica prej 75 € (350 të paguara krahasuar me 275 për tu paguar) mund të aplikohet për të ulur interesin për t'u paguar në kështin e tretë, por me efekt vetëm nga data e pagesës së kështit të katërt.

5.Nënparagrafi 2.2.2 i nenit 43 të Ligjit i referohet pagesave të bazuara në detyrimin tatimor të vitit të kaluar. Në rastin kur tatimpaguesi ka humbje tatimore për një vit të caktuar, atëherë në vend se të shfrytëzoj bazat e detyrimit tatimor të vitit të kaluar dhe aplikoj llogaritjen prej 110%, tatimpaguesi është i obliguar që të llogarit dhe paguaj kështet duke u bazuar në të ardhurat e tatueshme të parashikuara për vitin aktual. Nëse tatimpaguesi parashikon se gjithashtu do të ketë humbje në vitin aktual, apo çdo fitim do të tejkalohet nga humbjet e bartura përpara ,nuk do të ketë nevojë për këste,mirëpo do të zbatohet ndëshkimi dhe interesi nëse parashikimi i tatimpaguesit del i pa saktë.

Shembull:

Në vitin e 2010 biznesi i tatimpaguesit ka pasur një humbje. Në vitin 2011, tatimpaguesi parashikon se biznesi do të ketë fitim (pas lejimit të bartjes së humbjeve përpara) dhe detyrimi vjetor tatimor do të jetë 1.000 €. Gjatë vitit 2011 do të kërkohet që të paguhen kështet duke u bazuar në ¼ e detyrimit vjetor tatimor të parashikuar.

6. Në rastet kur ka pasur një kontroll tatimor ose ngjarje të tjera në vitin vijues që përcakton një detyrim tatimor vjetor të ndryshëm për një vit tatimor të mëhershëm në , nëse detyrimi vjetor tatimor është gjetur të jetë më i lartë, ndëshkimet do të aplikohen për nën-deklarim, për pagesa të vonuara dhe gjithashtu interesi në lidhje me detyrimin vjetor të paguar më pak. Ndëshkimet e tilla dhe interesi për detyrimin tatimor shtesë të zbuluar më pas do të aplikohet vetëm në detyrimin vjetor tatimor, dhe nuk do të bëhen rregullime në shumat e kësteve tremujore të kaluara ku rezultati i kontrollit tatimor apo ngjarjeve të tjera e ka ngritur detyrimin tatimor deri në 20%. Në rastet kur ka pasur ngritje të detyrimit tatimor për më shumë se 20% ,atëherë interesi ndëshkimi do të zbatohet për shkallën sa kësti tremujor ka qenë më ulët se ¼ e 110% e detyrimit të rregulluar të tatimit në të ardhura si rezultat i kontrollit tatimor ose ngjarjeve të tjera.

7. Formulari vjetor i Tatimit në të Ardhurat Personale është një deklaratë tatimore por pasqyrat tremujore të pagesave të paradhënieve nuk konsiderohen të jenë deklarata tatimore. Në përputhje me paragrafin 3 të nenit 43 të ligjit, ndëshkimet për deklarimin me vonesë dhe pagesën me vonesë nuk do të zbatohen për formularët e deklaruar me vonesë të kësteve tremujore, por interesi do të aplikohet përveç kur zbatohen dispozitat e nën-paragrafëve 3.1, 3.2 ose 3.3 të këtij neni.

Neni 14
Pagesat Tremujore të Paradhënieve për të Ardhurat nga Qiraja

Paragrafët 1 dhe 2 të nenit 44 të ligjit i obligon tatimpaguesit që të bëjnë pagesa tremujore të tatimit në të ardhurat personale për të ardhurat nga qiraja. Për qëllim të bërjes së këtyre pagesave tremujore, paguesit duhet të plotësojnë një formular tremujor për pagesat e paradhënieve ashtu siç përcaktohet nga ATK dhe do t'i dorëzojnë formularin dhe pagesën në një bankë ose institucion financiar të licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës.

Neni 15
Pagesat Tremujore të Paradhënieve për të Ardhurat nga Pasuria e Paprekshme

Paragrafët 1 dhe 2 të nenit 45 të ligjit i detyrojnë tatimpaguesit që të bëjnë pagesa tremujore për tatim në të ardhurat personale për të ardhurat nga pasuria e paprekshme. Për qëllim të bërjes së këtyre pagesave tremujore , paguesit duhet të plotësojnë një formular tremujor të pagesave të paradhënieve ashtu siç përcaktohet nga ATK dhe do t'i dorëzojë formularin dhe pagesën në një bankë ose institucion financiar të licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës.

Neni 16
Pagesat Tremujore të Paradhënieve nga të Ardhurat nga Dhuratat

Paragrafi 2 i nenit 46 të ligjit i obligon tatimpaguesit që pranojnë dhurata të tatueshme që të bëjnë pagesat tremujore për tatim në të ardhura. Në pajtueshmëri me paragrafin 2 të nenit 14 të Ligjit dhuratat e tatueshme janë dhuratat monetare dhe jo monetare (të tjera nga dhuratat e liruara nga tatuarja sipas paragrafëve 3 dhe 4 të nenit 14 të Ligjit) të pranuara nga rezidentët të cilët në çdo periudhë tatimore kanë një vlerë të kombinuar më të madhe se 5000 euro. Për qëllim të bërjes së këtyre pagesave tremujore , paguesit duhet të plotësojnë një formular tremujor të pagesës së paradhënies ashtu siç përcaktohet nga ATK, dhe do t'i dorëzojë formularin dhe pagesën në një bankë ose institucion financiar të licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës.

Neni 17
Dispozitat e Përgjithshme që Zbatohen në Pagesat Tremujore të Paradhënieve

1. Kapitulli XI i Ligjit parasheh se pagesat tremujore të paradhënieve do të derdhen në një bankë ose institucion financiar të licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës.

Transferimi bankar mund të bëhet në vend të pagesës me para të gatshme. Këto pagesa (duke përfshirë të urdhrat për transferimin e parave për transferime bankare) dhe formularët mund të dorëzohen në çdo degë të një banke ose institucioni financiar të autorizuar që i pranon ato. Me përjashtim të rasteve kur nga Drejtori i Përgjithshëm i ATK-s caktohen zyrtarët e caktuar tatimor për të mbledhur tatim sipas Ligjit mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, këto pagesa dhe formularë nuk do të dorëzohen në çdo zyrë apo te çdo zyrtar i ATK-s.

2.Pagesat e referuara në paragrafin 1 të këtij neni duhet të shoqërohen me pasqyrën e pagesave tremujore të avancit. Pasqyra e pagesave tremujore të avancit do të jetë:

2.1 për ata pagues të cilët dëshirojnë të shtojnë dhe janë në gjendje që të deklarojnë informatat e pagesave të tyre tremujore të avancit në ATK në mënyrë elektronike,një dëftesë e pagesës tremujore të avancit,

2.2 për paguesit tjerë,formulari i plotësuar i pasqyrës së pagesës tremujore të avancit sikur që përshkruhet nga ATK.

3. Kapitulli XI i Ligjit parasheh data të caktuara në të cilat do të dorëzohen formularët tremujor të pagesave të paradhënieve dhe në të cilat data duhet të bëhen pagesat tremujore të paradhënieve. Në çdo rast, kur data specifike e deklarimit dhe / ose pagesës është e shtune, e diele apo festë zyrtare, këta formular dhe / ose pagesat do të dorëzohen më së voni në ditën e parë të punës pas së shtunës, së dielës apo Festës Kombëtare. Nuk do të zbatohen interesi dhe ndëshkimet për deklarim ose pagesë me vonesë kur deklarimi dhe/ose pagesa ndodhin në ose para ditës së ardhshme të punës.

Neni 18
Hyrja në Fuqi

Ky Udhëzim Administrativ, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i Ekonomisë dhe Financave.

Bedri HAMZA

Zëvendësministër i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave

Datë 30 / 07/ 2010